


KOMITETI I



PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKES SË
MAQEDONSË



PASQYRA E SHKURTËR
E LEGJISLACIONIT
MAQEDONAS TË PUNËS



MBROJTJA E PUNËTORIT DHE KUSHTET ADEKUATE PËR PUNË

Të garantuara me Kushtetutë dhe të operacionalizuara në më tepër
zgjidhje ligjore.

TË DREJTAT E PUNËTORËVE JANË TË DREJTA TË NJERIUT

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut e garanton të drejtën e punës → secili ka të drejtë për punë, zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje në punë dhe sigurim material gjatë kohës së papunësisë së përkohshme.

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>



KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Çdo njeri, nën kushte të barabarta, e ka në dispozicion çdo vend pune, çdo njeri i punësuar ka të drejtë në përfitim përkatës dhe çdo njeri i punësuar ka të drejtë për pushim të paguar ditor, javor dhe vjetor.

Të drejtat personale absolute dhe të patjetërsueshme nga të cilat qytetarët nuk mund të heqin dorë:

- E drejta e punës
- E drejta e mbrojtjes në punë
- E drejta e sigurimit material gjatë kohës së papunësisë së përkohshme
- E drejta në përfitim përkatës
- E drejta në pushim ditor, javor dhe vjetor

LIGJI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

(Ndryshimi i fundit më 30.05.2019)

-Kushtetuta e veçantë për marrëdhëniet e punës-

Korniza e përgjithshme e të gjitha çështjeve lidhur me punën.

I rregullon:

Marrëdhëniet e punës midis punëtorëve dhe punëdhënësve e që themelohen me nënshkrimin e kontratës së punësimit.

Qëllimi i ligjit:

Përfshirjen e punëtorëve në procesin e punës dhe sigurimin e zhvillimit të pajtueshëm të këtij procesi, por duke e respektuar të drejtën e punëtorit për liri të punës, dinjitet dhe mbrojtje të interesave të punëtorëve në marrëdhënien e punës.

**Komiteti i Helsinkit, që nga gushti i vitit 2018 është pjesë e Grupit të Punës për përgatitjen e Ligjit të ri të Marrëdhënieve të Punës.*

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>

LIGJI I SIGURISË DHE SHËNDETTIT NË PUNË

(Ndryshimi i fundit më 18.12.2018)


QËLLIMI: inkuadrimi i masave që do të nxisin përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë

I përcakton:

- Masat e sigurisë dhe shëndetit në punë,
- Detyrimet e punëdhënësit dhe të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë,
- Masat parandaluese kundër rreziqeve profesionale,
- Mënjanimin e faktorëve të rrezikshëm për fatkeqësi,
- Njoftimin, konsultimin dhe trajnimin e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre, dhe
- Pjesëmarrjen e tyre në planifikimin dhe marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Aplikimi:

- Në të gjitha veprimtaritë e sektorit publik dhe privat,
- Për të gjithë personat e siguruar nga lëndimet në vendin e punës ose sëmundjet profesionale sipas akteve të sigurimit pensional, invalidor dhe shëndetësor dhe
- Për të gjithë personat e tjerë që përfshihen në proceset e punës.



LIGJI I PUNËSIMIT DHE SIGURIMIT NË RAST TË PAPUNËSISË (Ndryshimi i fundit më 20.06.2019)

- ndërmjetësimi në punësim, me qëllim që t'u ndihmohet punëdhënësve për t'i plotësuar vendet e lira të punës me punëtorë të kualifikuar, kurse të papunëve dhe personave të tjerë që kërkojnë punë t'u ndihmohet gjatë punësimit -

Rregullohen:

- Çështjet e shkëmbimit të punës,
- Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit, personave të papunë, personave të tjerë që kërkojnë punë dhe shtetit, në lidhje me punësimin dhe sigurimin në rast të papunësisë dhe
- Çështje të tjera me rëndësi për punësimin.

Të drejtën e kompensimit monetar (në para) ka personi i papunë që ka qenë në marrëdhënie pune të paktën 9 muaj pandërprerë ose 12 muaj me ndërprerje në 18 muajt e fundit.

LIGJI PËR MBROJTJE NGA SHQETËSIMI NË VENDIN E PUNËS

(Ndryshimi i fundit më 27.08.2015)

QËLLIMI: parandalimi dhe mbrojtja nga shqetësimi psikik dhe gjinor në vendin e punës, respektivisht vendin e punës dhe sigurimi i mjedisit të shëndoshë të punës.

Ndalohet çfarëdo lloji i shqetësimit në vendin e punës dhe i keqpërdorimit të të drejtave të shqetësimeve në vendin e punës.

- Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe punëtorëve në lidhje me parandalimin e shqetësimit psikik dhe gjinor në vendin e punës dhe në hapësirën e punës
- Masat dhe procedurat e mbrojtjes nga shqetësimi në vendin e punës
- Çështje të tjera që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen nga shqetësimi në vendin e punës

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>

LIGJI I NËPUNËSVE ADMINISTRATIVË

(Ndryshimi i fundit më 18.01.2018)

Lëndë e këtij ligji janë:

- Statusi,
- Klasifikimi,
- Punësimi, avancimi, trajnimi dhe aftësimi profesional,
- Matja e efektit,
- Çështje të tjera lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve administrativë dhe
- Statusi i kompetencës së Agjencisë së Administratës.

Nëpunës administrativ është personi i cili ka themeluar marrëdhënie pune për kryerje të punëve administrative në organet e shtetit dhe pushtetit lokal dhe organet e tjera shtetërore dhe institucionet që kryejnë veprimtari nga fusha e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe të fëmijës, sportit si dhe veprimtari të tjera me interes publik të përcaktuara me ligj, kurse të organizuara si agjenci, fonde, ente publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, nga qyteti i Shkupit si dhe nga komunat e qytetit të Shkupit.

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>

LIGJI I TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK

(Ndryshimi i fundit më 12.07.2019)

Lëndë e këtij ligji janë:

- Parimet e përgjithshme,
- Klasifikimi i vendeve të punës,
- Evidenca,
- Llojet e punësimit,
- Të drejtat e përgjithshme, detyrimet dhe përgjegjësitë,
- Mobiliteti dhe
- Çështje të tjera të përgjithshme lidhur me të punësuarit në sektorin publik.

Punëdhënës në sektorin publik, në përputhje me këtë ligj, janë: organet e shtetit dhe pushtetit lokal dhe organet e tjera shtetërore të themeluara në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin dhe institucionet që kryejnë veprimtari nga fusha e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe të fëmijës, sportit si dhe veprimtari të tjera me interes publik të përcaktuara me ligj, kurse të organizuara si agjenci, fonde, ente publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë ose nga komunat, nga qyteti i Shkupit si dhe nga komunat e qytetit të Shkupit.

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>



LIGJI I PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME INVALIDITET (Ndryshimi i fundit më 29.05.2018)

Person me aftësi të kufizuar sipas këtij ligji, është personi me shikim të dëmtuar, dëgjim të dëmtuar, me pengesa në zë, në të folurit dhe në gjubë, personi me aftësi të kufizuar trupore, personi me aftësi të kufizuar në zhvillimin intelektual dhe personi me aftësi të kufizuar të kombinuara, i cili për shkak të shkallës së invaliditetit ka nevoja specifike gjatë punës.*

Ky ligj rregullon kushtet e posaçme për punësimin dhe punën e personave me aftësi të kufizuara kur në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari si persona të vetëpunësuar tek një punëdhënës, ose që kanë cilësinë e punëdhënësit në administratën shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, entet, agjencitë dhe fondet dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe kushtet për themelimin dhe përparësitë në punë në shoqërinë tregtare për punësimin e personave me invaliditet – shoqëri mbrojtëse.

— Person me invaliditet konsiderohet edhe invalidi** i punës me aftësi pune të mbetur ose të reduktuar dhe nëse është i evidentuar si i papunë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

*Ligji e përdor termin “person i invalidizuar”

**Formulim i nxjerrë nga Ligji

LIGJI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR (Ndryshimi i fundit më 02.09.2019)

Me këtë ligj rregullohet sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor, përfshirja e të siguruarve, të drejtat që realizohen nga ky sigurim, evidenca amë e të siguruarve dhe shfrytëzuesve të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, bazat e sigurimit pensional me financim kapital, si dhe kushtet e veçanta në bazë të të cilave kategori të caktuara të të siguruarve i realizojnë të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor.

Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor është i përbërë prej:

1. Sigurimit të detyrueshëm pensional dhe invalidor sipas solidaritetit të gjeneratave (shtylla e parë);
2. Sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital (shtylla e dytë) dhe
3. Sigurimit pensional vullnetar me financim kapital (shtylla e tretë).

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>

LIGJI I MBROJTJES SHËNDETËSORE (Ndryshimi i fundit më 02.09.2019)

- Çdo njeri ka të drejtën e mbrojtjes shëndetësore dhe detyrimin që të kujdeset, ta ruajë dhe ta përmirësojë shëndetin e tij -

Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me sistemin dhe organizimin e mbrojtjes shëndetësore dhe kryerjen e veprimtarisë shëndetësore, të drejtat e garantuara dhe nevojat dhe interesat e konstatuara të shtetit në sigurimin e mbrojtjes shëndetësore, entet shëndetësore, punësimi, të drejtat dhe detyrimet, përgjegjësitë, vlerësimi, ndërprerja e punësimit, mbrojtja dhe vendimi për të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë, cilësia dhe siguria në veprimtarinë shëndetësore, dhomat dhe shoqatat profesionale, reklamimi dhe shpalljet e veprimtarisë shëndetësore, kryerja e veprimtarisë shëndetësore në kushte të jashtëzakonshme dhe vëzhgimi i veprimtarisë shëndetësore.

LIGJI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR (Ndryshimi i fundit më 28.11.2017)

- Çdo njeri ka të drejtën e mbrojtjes shëndetësore dhe detyrimin që të kujdeset, ta ruajë dhe ta përmirësojë shëndetin e tij. -

- Me këtë ligj rregullohet sigurimi shëndetësor i qytetarëve, të drejtat dhe detyrimet që dalin nga sigurimi shëndetësor, si dhe mënyra e zbatimit të sigurimit shëndetësor.
- Sigurimi shëndetësor konfirmohet si i detyrueshëm dhe si vullnetar. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor është për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut për sigurimin e shërbimeve shëndetësore dhe kompensimeve monetare mbi parimet e gjithëpërfshirjes, solidaritetit, barazisë dhe shfrytëzimit efektiv të mjeteve nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj.
- Sigurimi shëndetësor vullnetar vendoset për sigurimin e shërbimeve shëndetësore që nuk janë të përfshira me sigurimin e detyrueshëm shëndetësor.



LIGJI I PUNËSIMIT DHE PUNËS SË TË HUAJVE (Ndryshimi i fundit më 11.12.2015)

- i rregullon kushtet dhe procedurën me të cilat të huajt mund të punësohen ose të punojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut -

I huaji konsiderohet si person i punësuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut kur në bazë të kontratës për punësim do të themelojë marrëdhënie pune tek punëdhënësi, selia e të cilit ose vendbanimi gjendet në shtetin tonë ose kur të fitojë statusin e personit të vetëpunësuar në përputhje me këtë ose një ligj tjetër. Shërbimet e ofruara nga të huajt ose format e tjera të punës, të cilat i kryejnë të huajt në bazë të kontratës së punës ose kontratave të tjera sipas së drejtës civile, e të cilat zbatohen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë të kufizuar kohore, konsiderohen si punë të kryera nga ana e të huajve.

„I huaj“ është personi i cili nuk ka shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe/ose person pa shtetësi, respektivisht personi të cilin asnjë shtet, në bazë të ligjit të vet, nuk e konsideron si shtetasin e vet.

LIGJI I MBROJTJES SOCIALE (Ndryshimi i fundit më 17.07.2019)

Veprimtaria e mbrojtjes sociale sigurohet përmes realizimit të të drejtave të ndihmës financiare nga mbrojtja sociale dhe sigurimi i shërbimeve dhe masave të tjera sociale.

Rregullohen:

- Sistemi dhe organizimi i mbrojtjes sociale,
- Shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale,
- Të drejtat e ndihmës financiare dhe shërbimeve sociale,
- Procedurat për realizimin e të drejtave dhe shfrytëzimit të shërbimeve,
- Kryerja e veprimtarisë së mbrojtjes sociale,
- Personeli, financimi dhe vëzhgimi i kryerjes së mbrojtjes sociale, dhe
- Çështje të tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së mbrojtjes sociale.

Mbrojtja sociale është veprimtari me interes publik e cila realizohet përmes masave, aktiviteteve, programeve dhe politikave të mbrojtjes nga rreziqet sociale, parandalimit dhe tejkalimit të problemeve sociale të cilat në mënyrë të pafavorshme ndikojnë mirëqenien e qytetarëve, me qëllim: promovimi dhe qëndrueshmëria e sigurisë sociale, parandalimi i përjashtimit social, përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe fuqizimi i kapaciteteve të qytetarëve për një jetë të pavarur, aktive dhe produktive.

KONVENTAT E RATIFIKUARA NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar 80 konventa të ONP-së, por nuk e ka ratifikuar Konventën e Mbrojtjes dhe Shëndetit në Ndërtimtari, numër 167 të vitit 1988.

Republika e Maqedonisë së Veriut si anëtare e Këshillit të Evropës e ka pranuar dhe pjesërisht ka transponuar në legjislacionin e saj Deklaratën Sociale Evropiane të korigjuar të Këshillit të Evropës, numër 163, e vitit 1988, si dhe Konventën e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të vitit 1950, dhe protokollet e saj.

Procesi i aderimit, në të cilin po hyn Republika e Maqedonisë së Veriut, nënkupton përshtatjen e legjislacionit maqedonas me standardet e BE-së dhe transponimin konkret të direktivave të BE-së të kësaj fushe në legjislacionin kombëtar. Ky është një proces i gjatë dhe i vështirë, i cili tanimë ka filluar me krahasimin e zgjidhjeve ligjore dhe identifikimin e dallimeve.



Kjo pasqyrë e shkurtër e analizës është përgatitur në kuadrin e projektit “Rritja e produktivitetit përmes përmirësimit të kornizës ligjore për marrëdhëniet e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i financuar nga Fondi për qeverisje të mirë i Britanisë së Madhe, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinione dhe qëndrimet në këtë përmbajtje nuk i reflektojnë gjithmonë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Komiteti i Helsinkit është shoqatë e autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike, e regjistruar në Regjistrin Shtetëror të ofruesve të ndihmës paraprake juridike. Nëse konsideroni se të drejtat Tuaja janë rrezikuar, shkeljet mund t’i denonconi në mënyrë elektronike në ueb faqen e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në: <https://mhc.org.mk/sq/ndihme-juridike-falas/>, në numrin e telefonit falas: 0800 44 222, ose personalisht në zyrat e organizatës. Pas dërgimit të kërkesës me postë, postë elektronike ose paraqitjes në zyrën tonë, do Ju ofrohet një këshilltar juridik i cili do të punojë në lëndën Tuaj.

Zotimet e Komitetit janë të disponueshme në:
<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/1-Outreach-plan-Alb.pdf>

Për të gjitha pyetjet shtesë mund të na kontaktoni në:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup

+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436

helkom@mhc.org.mk



British Embassy
Skopje



RRITJA E
PRODUKTIVITETIT
PËRMES PËRMIRËSIMIT
TË LEGJISLACIONIT
PËR MARRËDHËNIJE
PUNE NË MAQEDONI

